



OZOT, M'FALE PARAJSËN

Historia e Vjedhësit në Kryq

COLIN S. SMITH
me TIMOTHY GREGORY



O Zot M'fale Parajsën
Historia e Vjedhësit në Kryq
Colin S. Smith me Timothy Gregory

Colin S. Smith

Themelues & Pastor Mësimdhënës

Pastor Colin Smith është President i Open the Bible dhe Pastor Emeritus i Kishës Orchard në periferinë veriperëndimore të Çikagos. Ai mund të dëgjohet çdo ditë në transmetimin radiofonik, Open the Bible. Colin është autor i shumë librave, duke përfshirë: Fly Through the Bible, Heaven, How I Got Here, dhe Momentum: Ndjekja e Bekimeve Të Perëndisë Përmes Lumturive.

*© 2025 nga Colin S. Smith, Timothy Gregory Botuar nga Open the Bible
Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem të rikthyeshëm ose të transmetohet në ndonjë formë dhe mjet, elektronik, mekanik, fotokopje, regjistrim ose ndonjë mënyrë tjetër; pa lejen paraprake të botuesit, përveç siç parashikohet nga ligji i të drejtës së autorit të Shteteve të Bashkuara.*

Në partneritet me

Hape Biblën
me pasturin Colin Smith

Për më shumë burime, vizitoni: hapebiblen.al/parajsa/



PËRSHËNDETJE, UNË QIHEM DIZMA, POR MUND TË MË NJOHËSH MË MIRË SI... EPO, DO TË KTHEHEM TE KJO PAS PAK...

UNË DO TË JEM UDHËRRËFYESI YT SOT.

MIRË SE VJEN NË PARAJSE.



EPO, GJITHSESI PËR MOMENTIN.

NDOSHTA E VËRE RE SE BILETA JOTE ËSHTË VETËM NJË KALIM I PËRKOSSHËM.



DO TË DOJA TË THEM SE MUND TË QËNDROSH, POR KY NUK ËSHTË VENDIMI IM.

KALIMI I PËRKOSSHËN NË PARAJSE



DHE PO, KY
VEND ËSHTË
I VËRTETË.

DHE TË JESH
KËTU...UAI.

ËSHTË SI NJË
GOSTI DASME QË NUK
MBARON KURRË. GJITHÇKA
ËSHTË E BUKUR NGADO
QË TË KTHEHESH.



NJË
NGA GJËRAT QË
PERËNDIA NA LEJON
TË BËJMË KËTU LART
ËSHTË TË TREGOJMË
HISTORITË TONA.

NE E BËJMË
ME RADHË GJATË
GJITHË KOHËS.
ËSHTË KËNAQËSI
E VËRTETË.



PËR
SHEMBULL. KY ËSHTË
VËLLAI YNË, JONAI, NË
BARKUN E BISHËS.

ME ALGAT DHE
PESHQIT QË QELBEN
ERË... DUHET TA DËGJONI
TË TREGOJË HISTORINË.
E PËRSHKRUAN EDHE MË
TË GJALLË.

PERËNDIA THOTË SE DUHET
TA FUSTE JONAIN PËR NJË KOHË
TË SHKURTËR NË BARKUN E PESHKUT,
QË TË MUND TË MENDONTE PËR GJËRAT.
MUA NUK DO TË MË DUHESHIN TRE DITË.
PAK TË NUHASJA ATË ERËN E QELBUR
TË PESHKUT DHE DO TË ISHA
QARTËSUAR, MJAFT SHPEJT.



KËTU SIPËR TË
GJITHË E KEMI
NJË HISTORI.



...DHE JA
E IMJA.

UNË ISHA NJË
NGA KRIMINELËT QË MË
VARËN NGJITUR JEZUIT,
NDËRSA AI VUAJTI DHE
VDIQ NË KRYQ.

ISHA NË BUZË TË FERRIT, POR
PËRFUNDOVA NË PARAJSË.



MË LEJONI
T'JU TREGOJ SESI
ARRITA KËTU.



JAM RRRITUR DHE
EDUKUAR THJESHTË DHE
NORMALISHT. BABAI SIGURONTE
TË ARDHURA MODESTE SI
NDËRTUES.



NËNA BËRI MË TË MIRËN
E SAJ PËR TË NA MËSUAR
TË MIRËN DHE TË KEQEN.



POR MENDOJA SE
BESIMI I NËNËS SIME
ISHTE QESHARAK.

ÇDO VIT GJATË
LDHËTIMIT TË GJATË
DREJT JERUSALEMIT,
NËNA LUANTE ME
NE "LOJËRA TË
SHKRIMIT"...

DIZMA,
VËLLAI YT MORI
NËNTË. TË DUHEN
DHJETË.



FILLO!

GATI?



MIRË...NUK
E DISKUTOJ
FARE!



MOS
KI PERËNDI
TJETËR PËRVEÇ
MEJE.

MOS
BËJ IDHUJ.



MOS E
MERR NËPËR
GOJË KOT EMRIN
E ZOTIT.

MBAJE DITËN E
SHTUNË DHE
SHENJTËROJE.







UNË E THASHË KËTË!



NUK E THE, MASHTRUES!



E THASH!



ZOTI DO TË GODASË PËR VDEKJE!

AI DO TË GODASË EDHE MË SHUMË SE ME VDEKJE!



DJEMA! MJAFT. SILLUNI MIRË!

PERËNDIA SHIKON. AI SHEH GJITHÇKA DHE NUK HARRON KURRË. TË MIRËN OSE TË KEQEN. DHE MBAJENI MEND: ÇKA TË MBILLNI DO TË KORRNI.



DROJA NDAJ ZOTIT ËSHTË FILLIMI I LURTISË.

DIZMA, A I DRUHESH ZOTIT?



A I DRUHESHA ZOTIT?

NJË DITË KUR ISHA 13 VJEÇ, NË DERËN
TONË U DËGJUA NJË TROKITJE...



TAK!

TAK!

ISHTE NJË TAGRAMBLEDHËS, DHE JO
NJË TAGRAMBLEDHËS DOSIDO, POR NJË
NGA ZYRTARËT E DOGANËS. ATA ISHIN
MË TË KËQIJTË E MË TË URRYERIT.

IM ATË ISHTE NJË
BURRË I FORTË...



NË ATË MOMENT AI DUKEJ
I FRIKËSUAR DHE I DOBËT.
UNË URREJA ATË QË ATA E
KISHIN SHNDËRRUAR.



PËRSHËNDETJE.

MIRË, KU
ËSHTË?

KU
ËSHTË??

ËSHTË
ATJE.



MMM...
MUAJ I MIRË!

ÇING!



EPO,
SIGURISHT, TAKSA E
ZAKONSHME MBI TË
GJITHA IMPORTET
DHE EKSPORTET

ÇING!

KLING!

TË GJITHA
MALLRAT E BLERA
DHE TË SHITURA.



TAKSA E URAVE,

PARA PËR RRUGËN,

OH,
DHE NJË E
RE, TAKSA E
PORTIT.

CINGGG!



TAKSAT E PORTIT? TRUPI MË I
AFËRT I UJIT ISHTE NJË PELLG.

PO NA GRABISNIN!



NË ATË ÇAST VENDOSA
QË KURRË NUK DO TË
BËHESHA SI IM ATË.


PO SHIKOJA. PASHË
GJITHÇKA DHE KURRË
NUK E HARROVA.

ATA DO TË KORRNIN
ATË QË MBOLLËN.



VITËT KALUAN, DHE
ZEMËRIMI IM U RRIË.


KUR SHKOJA NË TEMPULL, SHQUAJA NË
FYTYRËN E PRIFTIT TË NJËJTIN VËSHTRIM
PREJ HUMBËSË SI TE FYTYRA TIM ETI..



POR ÇFARË BËNIN ATA
KUNDRA PADREJTTËSISË
DHE SHTYPJES SË
DUKSHME ROMAKE?

AS EDHE NJË GJË PËR BE.

TEMPULLI ISHTE PA LIDHJE
KUR BËHEJ FJALË PËR T'U
MARRË ME JETËN REALE.



NJERËZIT PO
HIDHNIN PARA NË
ARKAT E TEMPULLIT.

SA DËM!

MUND TË
PËRDORESHIN PËR TË
FINANCIAR NJERËZ
QË DO TË LUFTONIN
KËTË ÇMENDURI.



TEMPULLI U BË SKENA E VJEDHJES SIME TË PARË, KUR ISHA 15 VJEÇ

I SHIHJA NJERËZIT TEKSA VENDOSNIN PARATË E TYRE NË ARKËN E THESARIT DHE ISHA I BEFASUAR NGA NIVELI I ULËT I SIGURISË.



DO TË ISHTE AQ E LEHTË T'I MERRJE PARATË PREJ ATY, SA Ç'ISHTE PËR ATA KUR I FUSNIN.




VËZHGOVA DHE PRITA ÇASTIN E DUHUR.




E BËRA. E DIJA QË ISHTE GABIM, POR U NDJEVA SHUMË MIRË.


DHE MENDIMI PËR TA BËRË SËRISH MË JOSHTE.




KËSHTU, E BËRA
PRAPË. DHE SI AI
QENI LAKMITAR, NUK
NGOPESHA DOT.




PO SIKUR TA KTHEJA KËTË
GJË NË NJË PËRFITIM
MË TË MADH PËR NJË
QËLLIM MË FISNIK?



PO SIKUR TË GJEJA NJË MËNYRË T'UA
MERRJA ATO PARA TAGRAMBLEDHËSVE
QË KISHIN VJEDHUR NGA NE?



KY U BË QËLLIMI IM.
VJEDHJA SA VINTE E
BËHEJ MË E LEHTË. SA
MË E LEHTË VJEDHJA,
AQ MË ARROGANT
E MOSKOKËÇARËS
BËHESHA UNË.



DHE KUR
HAJDUTI BËHET
MOSKOKËÇARËS...



...HAJDUTI KAPET.

ZEMËRIMI KUNDËR
ROMAKËVE MË KISHTE
DHËNË NJË QËLLIM,



POR TANI E DIJA SE
ATA DO TË MË BËNIN
SHEMBËLL.



KRRRAAAK!!

MËNGJESI.

SHIJO
VAKTIN TËND
TË FUNDIT.



PLAF!



KLANG!

KAQ ISHTE.
KJO ËSHTË DITA
QË DO TË VDES.



KA PËR TË QENË
NJË DITË ME DHIMBJE
TORTURUESE. POR UNË NUK
DO TË SHFAQ DOBËSI.

ROMAKËT
MUND TË MË THYEJNË
TRUPIN, POR NUK DO
TË MA THYEJNË DOT
KURRË SHPIRTIN.

DO
TË VDES SI
KUNDËRSHTAR
I TYRE.



TRE PREJ NESH U KRYQËZUAN ATË DITË. NJË NGA NJË NA GOZHDIAN MBI KRYQAT TANË.

NUK E PASHË TË PARIN TEKSA E GOZHDONIN, POR VËZHGOVA ME KUJDES TË DYTIN. IA MBËRTHYEN PARAKRAHUN TE TRAU I KRYQIT E MË PAS...



KËSHTU NDODH ME VJEDHËSIT!

BAM!

BUM!

AAAA!


PASTAJ MË NDODHI MUA.



BUM!

KËRC!

AAAA!!



NUK KA FJALË PËR TË
PËRSHKRUAR DHIMBJEN E
KRYQËZIMIT. ÇKA MUND TË TË
THEM ËSHTË SE URREJTJA
MË MBAJTI GJALLË.

FRYMËMARRJA
ISHTË POTHUAJSE
E PAMUNDËR, POR
ZBULOVA SE MUND TË
MERRJA FRYMË KLIR E
ÇOJA PESHËN E TRUPIT
DREJT KËMBËVE.

KËSHTU, E
ZHVENDOSJA
PESHËN SA PARA,
MBRAPA, MES
VARJES NGA DUART
DHE SHTYTJES
DREJT KËMBËVE.

ISHTË TORTURË
SIDOQOFTË.



I KRYQËZUARI I PARË PO TËRHIQTE SHUMË VËMENDJE. KRYQI I TIJ ISHTE NË QENDËR DHE AI I PERSONIT TJETËR VETËM DISA METRA LARG NË ANËN TJETËR.



NUK E KISHA VËNË RE DERISA E DËGJOVA TË FLISTE.

ATË,
FALI ATA.

ATA NUK
DINË ÇFARË
BËJNË.



T'I FALJA? LINË
DOJA T'I VRISJA!



DHE PASTAJ E PASHË.

מִיָּם, נוֹר, רוּחַ, יֵשׁוּעַ
Ἰησοῦς Ναζωραῖος Βασιλεὺς Ἰουδαίων
IESUS NAZARENUS, REX IUDAEORUM

KY ËSHTE JEZUI, MBRETI I JUDENJVE.

JEZUI, KISHA DËGJUAR PËR TË.
NGA NAZARETI. PRETENDONTE
SE ISHTE MESIA.



KISHA DËGJUAR
QË KISHTE BËRË
MREKULLI.

KISHTE SHËRUAR NJERËZ
DHE GJËRA TË TILLA.



AI MUND
TË ECË!

UNË MUND
TË VALLËZOJ!!!
HA HA!

NËSE AI MUND
TË BËJË VËRTET
MREKULLI, TANI
ËSHTE KOHA E
DUHUR PËR NJË
TË TILLË.

POR ËSHTE GJITHMONË
E NJËJTA GJË ME KËTA
TIPAT FETARË. KANË FJALË
TË MIRA, POR FJALËT E
TYRE SJELLIN VËRTET
SHUMË PAK NDRYSHIM NË
BOTËN REALE.



TA SHIHJA ATË DUKE U
PËRDREDHUR SI NJË
KRIMB NË GREP THJESHT
VËRTETOI MENDIMIN TIM.



LUTJET E TIJ PËR FALJE
NUK PËRKONIN ME
ÇEKIÇIN DHE GOZHDËT.

THELLË PËRBRENDA,
E PËRÇMOVA JEZUIN.



DHE JO VETËM UNË.

NËSE JE
BIRI I PERËNDISË,
ZBRIT NGA KRYQI.




AI BESON
NË PERËNDINË.
TA SHOHIM NËSE
PERËNDIA E DO!



NËSE ËSHTË
MBRETI I IZRAELIT,
LE TË ZBRESË NGA
AI KRYQ DHE NE DO
T'I BESOJMË!





יֵשׁוּעַ נַאֲצָרֶתִי בַּאֲרֵץ יְהוּדָא
ΙΗΣΟΥΣ ΝΑΖΩΡΗΤΗΣ ΒΑΣΙΛΕΥΣ ΙΟΥΔΑΙΩΝ
IESUS NAZARENUS REX IUDAEORUM

NËSE PERËNDIA DO
TË KISHTE NJË BIR,
AI NUK MENDOJ SE
DO TË KISHTE KËTË
PAMJE..



TI NUK JE BIRI I
PERËNDISË. NUK MUND
TË SHPËTOSH AS
VETEN TËNDE!



KY
"MBRET" NUK
KA BËRË ASGJË
PËR NE!

AI RRI
ATY VARUR E I
PAFLUQISHËM.



UNË
REFUZOJ TË JEM
I PAFUQISHËM!



DHE DO
TË TË LIRREJ...
DERI NË FRYMËN
E FUNDIT!




DHIMBJA MA
NXITI URREJTJEN.

E URREJA ROMËN. E
URREJA PERËNDINË. E
URREJA EDHE VETEN.

ISHA NË BUZË
TË FERRIT.

DHE MUND T'IA
NDIEJA SHIJEN
TASHMË.



ME TË VËRTETË NUK
DI TA SHPJEGOJ
ÇKA NDODHI MË PAS.

E VETMJA GJË QË
DI T'JU THEM ËSHTË
QË NJË QETËSI
E ÇUDITSHME MË
PUSHTOI SHPIRTIN,
DHE QË PËR HERË
TË PARË, FILLOVA
TË MENDOJ SHUMË
SERIOZISHT PËR
GJENDJEN TIME.

JETA IME PO
RRËSHQISTE.

AS NUK E KISHA
PLANIFIKUAR KËSHTU,

E AS NUK ISHA I
PËRGATITUR PËR KËTË.



VJEDHËSI NË KRYQIN
TJETËR PO BËRTISTE
DISA NGA GJËRAT
MË TË NDIJA QË
KISHA DËGJUAR
NDONJËHERË.

PRANDAJ, PO E VËZHGOJA
KËTË MBRET TË JUDENJVE
SESI DO TË PËRGJIGJEJ...

...DHE...

...AI NUK
BËZANTE.



THJESHT I
VËSHTRONTE,
DHE DURONTE,
DHE DURONTE,

AI THJESHT
QËNDRONTE... I HESHTUR.

PAPRITUR, MENDJA IME
KTHEHET NË KOHËN
KUR ISHA FËMIJË...



ULLUR ATJE NË
TEMPULL, DUKE
DËGJUAR LEXIMIN
E SHKRIMEVE TË
SHENJTA.

DËGJOJA SËRISH
ZËRIN E RABINIT
TEKSA FLISTE
PËR MESINË...




"AI U
KEQTRAJTLUA
DHUNSHËM, POR
NUK U ANKUA. AI NUK
BËZAJTI, ASHTU SI
QËNGJI QË E ÇOJNË
NË THERTORE."

PO
SIKUR TË
ISHTE AI?



DHE JA... TEK
DËGJOJ ZËRIN
E NËNËS... QË
MË THOTË...



"DIZMA, DROJA
NDAJ ZOTIT ËSHTË
FILLIMI I URTISË"

DROJA NDAJ ZOTIT...
UNË GJITHMONË
KISHA BESUAR TE ZOTI.

POR KA NJË
NDRYSHIM TË MADH
MES BESIMIT NË ZOT
DHE DROJËS NDAJ TIJ.


DISA NJERËZ THONË SE
BESOJNË NË ZOT, POR I
LËNË SHUMË PAK VEND
ATIJ NË JETËN E TYRE.

TA DRUASH ZOTIN DO TË THOTË
TA VLERËSOSH ATË ME FJALËT
DHE ME VEPRIMET E TUA.



KJO ËSHTË DIÇKA QË
NUK E KISHA BËRË
KURRË. ZGJODHA
RRUGËN TIME.

KISHA BËRË NJË
JETË NË LARGËSI
PREJ ZOTIT...




DHE TANI PO
VDISJA LARG TIJ
GJITHASHTU.



ÇFARË
DO TË NDODHË
ME MUA PAS
KËSAJ?



KU DO
TË SHKOJ NGA
KËTU?




SHTYVA VETEN LART PËR
TË QORTUAR VJEDHËSIN
NË KRYQIN TJETËR.

A
NUK E DRUAN
PERËNDINË?



A NUK KE FRIKË
NGA ZOTI??

**DRUAJ ZOTIN
FRINË NGA ZOTI!
FRINË NGA ZOTI!
FRINË NGA ZOTI!**



NE PO
NDËSHKOHEMI ME TË
DREJTË. NE PO MARRIM
ATË QË MERITJOMË.

POR
KY NJERI NUK
KA BËRË ASGJË
TË KEQE.

FJALËT E MIA ISHIN
PO AQ SURPRIZË PËR
MUA SA EDHE PËR TË
GJITHË TË TJERËT..

NËNA IME KISHTE THËNË,
"GJITHMONË DO TË
KORRËSH ATË QË MBJELL."

BËJ MIRË,
DHE GJITHÇKA DO
TË JETË MIRË. PO
BËRE KEQ, BËN MIRË
TË RUHESH!

NËSE KJO
ËSHTË E VËRTETË,
NUK KA SHPRESË
PËR MUA.

POR JEZUI FOLI
PËR FALJEN.


A MUND TË
MË FALË JEZUI
MUA?



NËSE JEZUI
ËSHTË MBRET,
AI DUHET TË KETË
NJË MBRETËRI.

ËËH
AH
ËËH

DHE NËSE
MBRETËRIA E TIJ
ËSHTË NË ANËN TJETËR
TË VDEKJES, NDOSHTA
AI MUND TË MË
NDIHMJË.



DUHEJ SHUMË GUXIM T'I
KËRKOJA NDIHMË, SIDOMOS
PASI LINË PO E SHAJA VETËM
PAK ÇASTE MË PARË.

POR NËSE AI SHPËTOI TË
TJERËT, NDOSHTA MUND TË
MË SHPËTONTË EDHE MUA.



JEZU,
KUJTOHU PËR
MUA KUR TË HYSH
NË MBRETËRINË
TËNDE.



AMEN!
SOT DO TË JESH ME
MUA NË **PARAJSE**.



PARAJSA.

BOTA KU NJERËZIT E
PERËNDISË GËZOJNË
PRANINË E TIJ.

NUK KISHA ASNJË
DYSHIM SE JEZUI
DO TË ISHTE ATJE
PASI TË VDISTE.



POR U TRONDITA NGA
PREMTIMI I TIJ SE DO
TË ISHA ATJE ME TË.

MENDOVA SE MBRETËRIA
E TIJ DO TË ISHTE NË
TË ARDHMEN E LARGËT.
PRANDAJ I KËRKOVA
TË MË KUJTONTE.

POR JEZUI E BËRI TË
QARTË SE NUK KISHA PSE
TË SHQETËSOHESHA SE
AI DO TA MBANTE MEND.

UNË DO TË ISHA ME TË
NË PARAJSË PARA SE
TË MBARONTE DITA.

KËTO ISHIN FJALËT MË
TË MREKULLUESHME
QË MË KISHTE THËNË
DIKUSH NDONJËHERË.



KOHA PO
KALONTE....



GATI TË
GJITHË KISHIN
SHKLIAR, VETËM DISA
NGA MIQTË E JEZUIT
QËNDRONIN PRANË.

AJO DUHET
TË JETË NËNA
E TIJ... SHIKO SI
PRET, QAN DHE
ADHLIRON.



MË BËRI TË MENDOJ PËR
NËNËN TIME, DHE SE SI
UNË IA THEVA ZEMRËN.

TË MË SHIHTE TANI
DO TË KISHTE QENË E
PADURUESHME PËR TË.




POR NËNA E
JEZUIT ISHTE ATY.

SI DUHET TË KETË QENË
PËR TË TEKSA SHIKONTE
TË BIRIN TË VUANTE?




NDJEVA
DHEMBSHURI
PËR TË.



DHEMBSHURI?
NGA LINË? NË MËNYRAT
E MIA KISHA QENË I
PASHPIRT DHE MIZOR...
POR TANI... PO NDIJEJA
DHEMBSHURI.

DIÇKA E ÇUDITSHME
PO NDODHTE NË
ZEMRËN TIME DHE E
DIJA SE KJO ISHTE
PËR SHKAK TË JEZUIT.



JEZUI SHIKOI
POSHTË DHE
I FOLI NËNËS
SË TIJ.

O GRUA,
JA BIRI YT!

AI NUK PO FLISTE PËR VETEN E
TIJ. AI PO FLISTE PËR GJONIN, I
CILI QËNDRONTE PRANË MARISË.




PASTAJ AI I
THA GJONIT...


JA
NËNA JOTE!

JEZUI PO I THOSHTË
GJONIT TË KUJDESEJ
PËR MARINË.

PËR 33 VITE,
JEZUI KISHTE
QENË I BIRI I
MARISË, POR KJO
MARRËDHËNIE PO
NDRYSHONTE.



MARIA LINDI
JEZUIN. AJO ISHTE
E PERENDISHME,
E MIRË, DHE
ZEMËRIBUTË.



POR MARIA ËSHTË
SOT NË PARAJSË, JO
SEPSE JEZUI ISHTE BIRI I
SAJ, POR SEPSE AI ËSHTË
SHPËTIMTARI I SAJ.

DHE PASTAJ...

...ERRËSIRË TOTALE.

KY DUHET
TË JETË GJYKIMI
I ZOTIT!

PO BIE MBI
USHTARËT QË
KRYQËZUAN
JEZUIN!


POR KJO
NUK NDODHI.

GJYKIMI I ZOTIT
PO BINTE MBI...

...BIRIN E TIJ.

BIRIN QË I
KISHA BESUAR.

BIRIN QË MË
KISHTE PREMTUAR
PARAJSËN.




KOKA PO MË
SILLEJ VËRDALLË
DHE KISHA PYETJE.

NËSE
JEZUI ISHTE
NËN GJYKIMIN E
PERËNDISË, ÇFARË
SHPRESE KISHTE
PËR MUA?



ATËHERË JEZUI
KLITHI NË AGONI...

PERËNDIA IM,
PERËNDIA IM, PËRSE MË
KE BRAKTISUR?




PSE DO
TA BRAKTISTE
PERËNDIA BIRIN
E TIJ?

NËSE JEZUI
ISHTË BRAKTISUR,
NUK DO TË KISHTË
PARAJSË AS PËR TË...
AS PËR MUA

TANI E DI PSE JEZUI U
BRAKTIS. NË KRYQ, AI PO
DURONTE DËNIMIN PËR
MËKATET E MIA, QË UNË TË
MUND TË HYJA NË PARAJSË.

E KUJTOVA RABININ
DUKE LEXUAR FJALËT
E SHKRIMIT.

AI U TEJSHPLIA
PËR SHKELJET TONA, U
SHTYP PËR PALDHËSITË
TONA; NDËSHKIMI QË NA
DHA PAQEN, RA MBI TË,
PREJ VURRATAVE TË TIJ
NE U SHËRLIAM.



JEZUI I MBARTI MËKATET E
MIA NË VDEKJEN E TIJ...

...QË UNË TË MOS I
MBARTJA NË TIMEN.

PO FILLOJA TË
HYJA E TË DILJA
NGA VETËDIJA.

KUR DËGJOVA ZËRIN E
JEZUIT. JO TË DOBËT... POR
TË LARTË E TË FORTË.

U KRVE!

**O ATË, NË DUART
E TUA E DORËZOJ
SHPIRTIN TIM.**

KUR NJERËZIT VDESIN, ZËRI
U DOBËSOHET... SI NJË
PËSHPËRITJE. POR ZËRI I
JEZUIT ISHTE NGADHËNJYES.

AI HYRI NË VDEKJE, JO NË
DISFATË, POR NË FITORE.

PASTAJ...
SHPËRTHEU I
GJITHË FERRI.

TËRMET!!

GRRRIN!

BURRIN!

MOS KISHTE
ARDHUR FUNDI?

KRRRAK!

NE SAPO KISHIM
KRYQËZUAR BIRIN
E PERËNDISË!



U BËRA GATI E PRITA SE Ç'DO TË NDODHTE MË PAS.



PASTAJ, PO AQ BEFAS SA FILLOI TË GJËMONTE TOKA, U QETËSUA SËRISH.

...DHE ERRËSIRA U LARGUA.



"ME SIGURI KY ISHTE BIRI I PERËNDISË!"

NJERIU QË KISHTE KRYQËZUAR JEZUIN NDANTE TANI TË NJËJTIN BESIM ME MUA.



KISHA MENDUAR SE DO TË VDISJA I PARI, DHE SE JEZUI DO TË MË NISTE PËRPARA TIJ.

POR JEZUI SHKOI I PARI, QË TË MË, MIRËPRISTE NË QIELL.

KRYQËZIMI ËSHTË NJË VDEKJE E NGADALTË, DHE PAS MË SHUMË SE 6 ORËSH, USHTARËT MORËN URDHËR T'I JEPNIN FUND.



TA MBYLLIM KËTË PUNË!
VRITINI KRIMINELËT
DHE RRËZONI KRYQET!"

KËMBËT E MIA ISHIN SHËNJESTRA E TYRE.



PA NDIHMËN E KËMBËVE, NUK KISHA FORCË TË NGRIJA TRUPIN QË TË MUND TË MERRJA FRYMË.

VETËM DISA MINUTA DHE...



ATA KALUAN TEK VJEDHËSI NË ANËN TJETËR TË JEZUIT DHE IA THYEN EDHE KËMBËT.

KUR I ERDHI RRADHA JEZUIT.




KY PASKA VDEKUR TASHMË.

MË MIRË TË SIGUROHEMI. TË MOS KETË ASNJË DYSHIM.




GJËJA E FUNDIT QË PASHË NË KËTË TOKË ISHTE GJAKU I JEZUIT QË DËRDHEJ KUDO PËRDHE.






VDEKJA ËSHTË
NJË VEND I ERRËT.

POR JEZUI KISHTE
KALLIAR PËRMES SAJ
TASHMË, DHE E KISHTE
BËRË ATË NJË VEND
TË SIGURT PËR MUA.




DIKUR PYESJA
VETEN SESI
DO TË ISHTE
UDHËTIMI I
SHPIRTIT KUR
AI TË LINTE
TRUPIN TIM.

MENDIMI ISHTE
I TMERRSHËM.



POR REALITETI
ISHTE SHUMË
NDRYSHE.

PAS ORËVE PLOT
DHIMBJE, MBYLLA SYTË,
DHE ISHA I LIRË. DHE KUR
ERDHI MOMENTI, E DIJA
SE NUK ISHA VETËM.





HISTORIA
IME VËRTETON SE
HYRJA NË PARAJSË
VARET NGA JEZUI DHE
VETËM JEZUI.

AI HAP
DERËN PËR TË
GJITHË ATA QË
BESOJNË NË TË.



JEZUI MA
PUSHTOI ZEMRËN E MA
RROKU MENDJEN. AI MË
SHPËTOI E MË PAJTOI
ME PERËNDINË



QË MË
SJELL NË
MENDJE.



KJO ËSHTË
E PREFERUARA IME.
TITULLOHET, "PAJTIMI."
KËTA JEMI NE. U PIKTURUA
VETËM JAVËN E SHKUAR.

A NUK ËSHTË E
MREKULLUESHME
KJO GJË?



PARAJSA
ËSHTË MË E
MIRË SE SA MUND
TA IMAGJINOSH.



KAM PASUR
MJAFT KOHË PËR
TË REFLEKTUAR MBI
TË GJITHA KËTO, MBI
DY MIJË VJET, PËR TË
QENË I SAKTË. DHE
JA E VËRTETA.

UNË NUK U
SHPËTOVA PËR SHKAK
TË NDONJË GJËJE QË
KISHA BËRË OSE NUK
KISHA BËRË. U SHPËTOVA
NGA AJO QË BËRI JEZUI...
PIKËRISHT ATJE LART
NË ATË KRYQ.

JEZUI
MË FUTI NË
PARAJSË DHE AI
MUND TË BËJË
TË NJËJTËN
GJË PËR TY.

Pyetje për reflektim:

1. Cfarë është një gjë që të ra në sy rreth fëmijërisë së (vjedhësit) Dizmait?
2. Si u ndjeve kur mësove se Dizmai po vidhte para nga tempulli? A druan Perëndinë? (A i jep peshë Atij në gjërat që thua dhe bën)
3. A mendon se Dizmai ishte mjaftueshëm i mirë për të hyrë në parajsë? Pse po ose pse jo?
4. A u befasove nga reagimi i Jezuit ndaj Dizmait? Pse po ose pse jo?
5. Çfarë është një gjë që mësove rreth Jezuit në këtë histori?

6. A mund të japësh një arsye pse mendon se mund t'i besosh Jezuit?

7. Me fjalët e tua, si hyri Dizmai në parajsë?

8. Si shpreson të hysh në parajsë një ditë?

9. A DËSHIRON të kthehesh te Jezui tani?

10. A do t'i kërkosh të të shpëtoj dhe t'i besosh atij që ta bëjë këtë?

PËRDORE këtë lutje për t'u kthyer, për të kërkuar dhe për të besuar tani.

ZOTI Jezu, unë rrëfej se jam një mëkatar, dhe kthehem nga mëkatet e mia tek ti. Besoj se ti je Mbreti, dhe se ti vdiqe në kryq për mua. Më fal. Më shpëto. Më fut në Mbretërinë tënde. Dhe më ndihmo tani të jetoj si dikush që beson në ty.

